



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI

P/VENDIM

Nr. ___ date __. __. 2024

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË BASHKISË PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR MUAJIN JANAR 01-31.01.2024.

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimt të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, vendimit Nr 85 datë 10.02.2021, si dhe bazuar në Udhëzimi nr.4 datë 17.02.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pika 7, Ligjit nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit 68/2017 “Mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore” VKB nr. 113 datë, 14.12.2023 për “Për Miratimin Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024” është miratuar fond “Ndhima Ekonomike” me fond limit 1.800.000 lekë/ vit, Këshilli i Bashkisë Gjirokastër.

VENDOSI :

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Janar 2024, 39 individë/ familje me fond 118,402 lekë.**
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT
Merita ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK GJIROKASTËR

P/VENDIM

NR _____, DATË _____.

“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE AFATMESME 2025-2027”

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _____ pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për miratimin e raportit të vlerësimit të të ardhurave afatmesme 2025-2027”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njëtitë e pushtetit vendor” si dhe në mbështetje të VKB nr 106, datë 14.12.2023 “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025”.

V E N D O S I

1. Të miratoj raportin e vlerësimit të të ardhurave afatmesme 2025-2027 sipas dokumentit bashkëngjitur vendimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Gjirokastrë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita Isaraj

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI

P/ VENDIM

Nr. ___ datë __. __. 2024

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMI E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK- NDIHMËN EKONOMIKE DERI NE 6% PËR MUAJIN JANAR 01-31.01.2024.

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597, date 04.09.2019 për “Për Përcaktimin e Procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Këshilli i Bashkisë Gjirokastër, me propozim të kryetarit të bashkisë Gjirokastër;

VENDOSI :

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Janar 2023, 8 (tetë), individë/ familje** me fond **25,919 lekë**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KËSHILLIT
MERITA IRASAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

P/VENDIM

Nr. _____ DATË ____/____/2024

MBI

“MIRATIMIN E LISTËS SË PARCELAVE KULLOSORE VERORE/DIMËRORE QË
DO TË KONTRAKTOHEN PËR PËRDORIMIN ME QIRA PËR KULLOTJE PËR
SEZONIN VEROR 2024 DHE SEZONIN DIMËROR 2024-2025 ”

Në mbështetje të ligjit 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në Nenin 26 të Ligjit Nr.49/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kulloros” (të ndryshuar), si dhe në Nenin 2 të Udhëzimit Nr. 2, datë 27.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje dhe kositje bari” të Ministrisë së mjedisit, Këshilli i Bashkisë Gjirokastër në mbledhjen e datës ____/____/2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë parcelat kullosore verore dhe dimërore sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita Isaraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

P/ VENDIM

Nr. _____ datë . ____ .2024

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR INDIVIDË/FAMILJE QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDE NGA BUXHETI I SHTETIT DHE BASHKIA GJIROKASTËR NË 2024, PASI E KANË TË VËSHTIRË TË PËRBALLOJNË QIRANË NË TREGUN E LIRË”.

Në mbështetje të nenit 24 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 „Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; neni 39, pika 3 të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas programit social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendor”, VKM nr. 362 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet Buxhetit të Shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij“, VKB-së, Nr 109, datë 14.12.2023 “Për Miratimin e Vlerës Maksimale të Subvencionimit të Qirasë dhe të Nivelit të Qirasë në Treg të Lirë”, Proces-Verbalin e Komisionit të Strehimit, datë 18.01.2024, Nr 362 prot, “Për Miratimin e Vlerës si dhe Listës së Përfituesve për Programin e Subvencionimit të Qirasë në Tregun e Lirë nga Fondet e Buxhetit të Shtetit dhe Bashkisë Gjirokastër”, Këshilli i Bashkisë, Gjirokastër, më datë ____ / ____ 2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI.

- 1- Miratimin e listës së individëve/familjeve dhe vlerën e subvencionit të qirasë
- 2- Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë 1 (një vjeçare) dhe vlera financiare për llogaritjet që nga dita e lidhjes së kontratës së qirasë.
- 3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të tij.

SEKRETAR I KËSHILLIT

ETLEVA YZO

KRYETAR I KËSHILLIT

MERITA ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
NR. _____, DATË ____:____:2024

“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË BUXHETIT VENDOR, PËR FAMILJET DHE INDIVIDËT NË NEVOJË QË REZULTOJNË ME PIKË TË PAMJAFTUESHME NGA SISTEMI I PIKËZIMIT PËR VITIN 2024”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 21, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreut IV, pika 1, të vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar, të Këshillit ,me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, nw mbledhjen e datws _____, 2024,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kriteret mbi përdorimin e fondit të buxhetit vendor për bllok-ndihmën Ekonomike si më poshtë:
 - 1.1. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar për ndihmën ekonomike dhe të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.
 - 1.2. Do të përzgjidhen ata aplikues që kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni.
 - 1.3 Prioritet do të kenë familjet me nevoja social-ekonomike të theksuar:
 - a. familje të cilat sigurojnë të ardhura të pamjaftueshme dhe në përbërje të tyre kanë të mitur.
 - b. familje me 1 (një) anëtar,
 - c. vajza/gra kryefamiljare të divorcuara/të veja me fëmijë në ngarkim,
 - d. kryefamiljar që me vendim gjyqate kanë në ngarkim fëmijë të mitur,
 - e. familje me më shumë se 4 (katër) anëtarë, dhe në përbërje të tyre kanë të mitur.
 - f. familje të cilat kane në përbërje të tyre persona me P.A.K, status verbërie/para-tetraplegjisë/ status invalid pune.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore).
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Etleva YZO

KRYETARI I KËSHILLIT
Merita ISARAJ